

VENDIM
Nr. 55, datë 29.12.2017

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër, me:
Drejtues ligjor: Mark Molla
Drejtues teknik: Lazer Pemaj
Drejtues teknik: Blerina Arrtunda
2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
Kategoria D: Për përpunimin e ujërave të ndotura (ITUN-ja e Shirokës dhe e Velipojës).
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Shkodër.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani